



Misioni në Kosovë

Misionit të OSBE-së në

Kosovë i është besuar roli

udhëheqës për çështjet që

kanë të bëjnë me ndërtim

institucional dhe të

demokracisë, me shtet ligjor

dhe me të drejta të njeriut

në rajon. Misioni e formon

kështu një komponentë të

veçantë apo "degë" të

Administratës së Përkohshme

të Misionit të Kombeve të

Bashkuara në Kosovë

(UNMIK), dhe ndër të tjera

është përgjegjëse edhe për

trajnimin e administratorëve

të policisë, civil dhe ata

të drejtësisë; vazhdimin e

zhvillimit të shoqërisë civile;

përkrahjen e zhvillimit të

mediave; organizimin dhe

mbikqyrjen e zgjedhjeve; dhe

mbikqyrjen, mbrojtjen dhe

përparimin e të drejtave

të njeriut.



ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

Misioni në Kosovë

Promovimi i të Drejtave të Njeriut në Kosovë

Hyrje

Respektimi i të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit është bazë e një shoqërie demokratike dhe paraqet një kornizë të qartë të trajtimit të njeriut. OSBE-ja, shtylla e ndërtimit të institucioneve përbrenda UNMIK-ut, është organizata udhëheqëse dhe përgjegjëse për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ajo poashtu ndihmon në ngritjen dhe shtimin e kuadrove vendore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Detyra e OSBE-së lidhur me të drejtat e njeriut përfshin monitorimin (përcjelljen) e sistemit ligjor duke siguruar ndihmë dhe përkrahje për viktimat e krimeve të rënda, detyrave të policisë dhe ngritjes së vetëdijes lidhur me të drejtat e njeriut. Duke iu përgjigjur nevojave të situatës që vazhdimisht ndryshon në Kosovë, OSBE-ja përqendrohet në lëmi të caktuara që të kuptohen më mirë të drejtat e njeriut nga strukturat që do t'u shtohen përgjegjësitë me kohë. Kjo padyshim ndihmon në krijimin e një kulture të të drejtave të njeriut.

Bregat Lidhur me të Drejtat e Njeriut / Monitorimi

OSBE-ja ka luajtur rol qenësor në monitorimin dhe dokumentimin e shkeljes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Ekipe të OSBE-së së të drejtave të njeriut rregullisht raportojnë për çështje të përgjithshme brengosëse siç janë e drejta për proces të rregullt gjyqësor, e drejta për pronësinë dhe shtëpinë dhe lirinë nga diskriminimi mes tjerash. Raporte të veçanta kanë dalur nga OSBE-ja lidhur me disa raste të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe mund ti gjeni në www.osce.org/kosovo/publications/reports.

Sistemi Ligjor

Një nga lëmitë ku OSBE-ja bën përpjekjet më të mëdha për monitorimin e të drejtave të njeriut është sistemi ligjor, një nga institucionet më kritike në Kosovë por padyshim qenësore për zhvillimet demokratike. OSBE-ja ka për detyrë që të ndihmojë në zhvillimin e mekanizmave të nevojshëm që sistemi ligjor të veprojë në përputhje me standardet ndërkombëtare apo drejtësinë ligjore me të drejtat e njeriut. Brenga më e madhe është monitorimi i krimeve etnikisht të motivuara, aktiviteteve kriminale politikisht të motivuara, dhunimeve dhe krimeve seksuale, trafikimi, të sëmurët mental dhe të rinjtë. Mënyra e trajtimit të femrave në këtë sistem shpie kah një brengë tjetër, mbrojtja e viktimave të krimeve të rënda. Në vitin 2002, monitorimi është zgjeruar për të përfshirë edhe raste civile.

Mbrojtja dhe përkrahja e viktimave

Një prioritet tjetër i OSBE-së është përkrahja dhe mbrojtja e viktimave të krimit, posaçërisht viktimave të trafikimit, dhunës seksuale dhe dhunës në familje, fëmijëve dhe viktimave me çrregullime mentale. Kjo bëhet për t'u ofruar viktimave shërbime të mirëfillta që të mos viktimizohen përsëri. Korniza e përgjithshme e të drejtave të viktimave kërkon një sistem gjithëpërfshirës që do t'i adresonte viktimat e krimeve dhe keqpërdorimin e pushtetit (pozitës). Tu përgjigjesh viktimave nënkupton zhvillim në shumë sektorë, nga përgjigja e policisë e deri te shërbimi i gjykatës apo raste të tjera. Kjo fillon me krijimin e policisë së mirëfilltë dhe kornizës ligjore, në pajtueshmëri me standardet e të drejtave të njeriut, të shoqëruara me mekanizma përkrahës, siç është rrjeti i akterëve qeveritar dhe joqeveritar, që përfshin përgjigje të ndieshme ndaj viktimës.

OSBE-ja ka punuar që të sigurojë mbrojtje ligjore të viktimave dhe rol institucional për mbrojtjen e viktimave përmes themelimit të një bazë ligjore për një sistem të tillë në draftin e Ligjit të Procedurës Penale të Kosovës. Specializimi i mbrojtjes së viktimave që siguron informacione,

Për informata të tjera, kontaktoni me

Zyrën për informim publik të OSBE-së, Prishtinë

Zyra e shtypit: +381 38 500 162 ext. 260

Zyra e informimit publik: +381 38 500 162 ext. 145

Fax: +381 38 500 188 E-mail: press@omik.org

Website: www.osce.org/kosovo

përkrashe dhe referime ligjore për të gjitha viktimat e krimeve është një zhvillim i ri dhe pozitiv për shërbimet ligjore dhe sociale dhe përkrasht nga komuniteti ligjor i Kosovës dhe OJQ-të që mirren me çështje të tilla. Advokatët që specializojnë në mbrojtjen e viktimave do të përfitojnë nga doracakët e mbrojtjes së viktimave.

Aktivitetet që luftojnë trafikimin në Kosovë janë pjesë e programit të përgjithshëm të OSBE-së që t'u përgjigjen nevojave të viktimave. Rëndësia kryesore e përpjekjeve të tilla është të përcillet se a realizohet me efektivitet rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 "Ndalimi i trafikimit të personave në Kosovë" sipas të cilit trafikimi i njerëzve mirret si vepër penale si dhe një zhvillim i mëtejshëm i parimeve dhe legjislativit. Kjo përfshin edhe themelimin e një rrjeti referues asistues që do t'i mundësonte viktimave të trafikimit që duan të kthehen në shtëpi të dërgohen në strehimore, t'u jepen shërbime këshilluese dhe këshilla ligjore dhe ndihmë. Duke e pasur parasysh seriozitetin e kësaj çështjeje, OSBE-ja ka siguruar ca trajnime për gjykatës, prokurorë, avokatë, policë dhe OJQ-të vendore që të ngrisin kuadrot që mirren me trafikim.

Pronësia

E drejta e pronës ndikon në të gjitha komunitetet e Kosovës. Trashëgimia e ligjeve diskriminuese, shpërnguljes së popullatës, dëmet në pronë, sfidat në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pronësisë dhe mungesa e sigurisë, të gjitha këto kontribuojnë në shkeljen e të drejtave të njeriut. Përveç këtyre ndikon edhe mungesa e një policie qendrore, të kuptuarit dhe respektimi i kornizës ligjore në Kosovë që shpie kah qasje të ndryshme në tejkalimin e problemeve të pronësisë. Mohimi i të drejtës së pronësisë ndikon veçanërisht në komunitetet e vogla të Kosovës si dhe në përpjekjet për të krijuar kushte për kthimin e personave të zhvendosur dhe refugjatëve.

OSBE-ja ka ndërmarrë një mori masash, të nivelit të ndryshëm që të mirret me mbrojtjen e të drejtave mbi pronësinë në Kosovë. Zyrtarët e të drejtave të njeriut në terren janë duke përcjellur (monitoruar) dhe nxjerrë në pah çështjet serioze të të drejtave të pronësisë siç janë marrja ilegale e pronësisë, largimi dhe dhënia e shtëpisë/pronës. Kjo përfshin bashkëpunimin e ngushtë me Drejtorinë për Çështjeve Pronësore dhe Banesore, institucion ky i krijuar nga UNMIK-u që të zgjedh çështjet e ngatërresave të pronësisë lidhur me qasjet dhe parimet për të vazhduar më tej me legjislationin e pronësisë që këto mosmarrëveshje të zgjidhen.

Jodiskriminimi

Të gjithë personat e një shoqërie duhet të mbrohen që të mos shkelen të drejtat e tyre. Sido që të jetë, vëmendje dhe mbrojtje të veçantë duhet t'u jepet grupeve të caktuara të pakicave, grave dhe fëmijëve, personave të paafër, personave të zhvendosur apo grupeve të tjera të rrezikuara që janë të rrezikuara nga diskriminimi etnik, religjioz apo lingvistik.

Pjesa kryesore e punës së OSBE-së është që në përvojën diskriminuese të aplikojnë standardet evropiane të të drejtave të njeriut lidhur me mungesën e diskriminimit dhe mbrojtjen e pakicave. Synimi i tyre është që të parandalojnë diskriminimin publik duke i përcaktuar fillimisht shkaktarët kryesorë, kryesisht në udhëheqjen e institucioneve qeveritare dhe në administrimin

publik si dhe rekomandimin e zgjidhjeve, përfshirë ndryshimet strukturale dhe reformat ligjore.

Sa i përket personave të zhvendosur dhe pjesëtarëve të komuniteteve të Kosovës që jetojnë jashtë Kosovës, diskriminimi në të gjitha format mund të jetë një faktor i rëndësishëm në vendimin për kthim. OSBE-ja ka për qëllim që të bëjë një intervenim të përshtatshëm, efektiv dhe strategjik që të adresoj shkeljen e të drejtave të njeriut që kanë ndikim te një numër i madh i pjesëtarëve të komunitetit. Një zgjidhje efektive ligjore për viktimat e diskriminimit jo vetëm që i mbron anëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë por edhe u ndihmon në të drejtën e kthimit.

Si pjesë të kësaj pune, OSBE-ja së bashku me UNHCR-në ka përgatitur një mori vlerësimesh të situatës së pakicave në Kosovë. Këto studime japin hollësi të çështjeve si siguria, pronësia dhe më së shumti diskriminimi, gjersa hapa efektiv duhet të bëhen që të mbrohen të drejtat e njeriut të të gjitha komuniteteve

Siguria

Që nga viti 1999, OSBE-ja ka monitoruar të drejtat e njeriut në përputhje me përdorimin e ligjit që të siguroj se të drejtat individuale të njeriut respektohen dhe mbrohen. Qëllimi kryesor është që të sigurohet një forcë policore efektive dhe përgjegjëse si dhe të identifikohet mosrespektimi i ligjeve dhe të drejtave të njeriut nga policia dhe të gjenden arsyet pse nuk mbrohen të drejtat e të tjerëve në mënyrë adekuate. Përqëndrimi kryesor është zhvillimi i Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) dhe akterëve që ndikojnë në punën e SHPK-së. Aktiviteti kryesor i ngritjes së kuadrove është të punohet me Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës që personat vendorë ligjorë të kuptojnë, të jenë në gjendje si dhe të kenë vullnet të mbrojnë të drejtat e njeriut.

Avansimi i të Drejtave të Njeriut

Të drejtat e njeriut janë baza e punës së OSBE-së dhe kjo arrihet përmes ngritjes së kuadrove profesionale dhe ngritjes së vetëdijes për të drejtat e njeriut përmes aktiviteteve edukative dhe trajnimeve. Qëllimi kryesor është që të arrihet një ekuilibër në mes të të drejtave të njeriut dhe përgjegjësisë të njeriut që të drejtat e njeriut dhe përgjegjësitë shoqërore të mos injorohen si dhe të zhvillohet një kulture aktive dhe gjithëpërfshirëse e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Trajnuesit e të drejtave të njeriut punojnë aktivisht me grupet e caktuara që të mund të vlerësojnë më mirë nevojat e tyre dhe krijojnë programe. Një qasje e tillë është adaptuar që të tregohet në mënyrë praktike se si të drejtat e njeriut janë pjesë integrale e jetës së përditshme dhe janë të lidhura në mënyrë direkte dhe ndikojnë në punën e tyre. Përqëndrimi kryesor është që të ndihmojmë ekspertët vendorë dhe institucionet që të ngrisin këto kuadro dhe të ndërmarrin aktivitete të të drejtave të njeriut. Trajnimi mbi standardet e të drejtave të njeriut i forcon dhe thekson çështjet kritike të të drejtave të njeriut dhe është mbajtur edhe në shkollë, me mësuesit dhe nxënësit, autoritetet komunale dhe shërbimin civil, OJQ-të dhe grupet qytetare, komunitetin ligjor, Shërbimin Policor të Kosovës dhe mediat.

